

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City
ADRESA	https://albeu.com/sport/maran-hap-listen-e-madhe-rreth-50-ftesa-per-kombetaren-mes-tyre-3-lojtare-te-dinamo-city/1011939/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 06:38:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 06:32:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e34b2d6dd4fc56bf8493408cf2b430f2dfc18b6efb0173864015f78b266073df
TEKSTI	d96377ff49a549cd53200c38e095ebcb2464d3a3233592421c376694242984ab
PAMJA	4cf9eda075ab3e696850f906504e5da8a58d535241f8104514b72e445cb28d74

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	97ef3a806a6a508c8644794c74def360509be57915bfe44def87fac4d0923626
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	144dcc84d15b7d80530ccf1620af6bb24eccd27028b717aa2669aa241970dde3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/97ef3a806a6a508c8644794c74def360509be57915bfe44def87fac4d0923626>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City



Federata Shqiptare e Futbollit, ka bërë të ditur se lista zyrtare e Kombëtares për ndeshjet e radhës, do të publikohet më 18 shtator, në të njëjtën kohë me konferencën për shtyp të trajnerit Rolando Maran.

Por pas kësaj liste, pritet të fshihet një panoramë shumë më e gjerë e futbollistëve të vëzhguar nga stafi i trajnerit italian.

Sipas informacioneve ekskluzive që Top Channel disponon nga burimet e gazetarit Endi Tufa, Rolando Maran, ka shpërndarë rreth 50 ftesa në funksion të këtij grumbullimi.

Natyrisht, kjo nuk do të thotë se të gjithë këta lojtarë do të jenë pjesë e listës përfundimtare. Trajneri ka dashur të ketë një panoramë sa më të gjerë, të vlerësojë gjendjen e lojtarëve dhe të shohë nga afër edhe disa profile të reja.

Për këtë arsye, lista përfundimtare pritet të jetë më e gjerë se zakonisht. Maran kërkon të ketë alternativa në dispozicion dhe njëkohësisht të testojë disa emra që mund të bëhen pjesë e Kombëtares në të ardhmen.

Një prej risive është Sabah Kerjota. Sulmuesi shkodran i Hearts, ka tërhequr vëmendjen me paraqitjet e tij në Skoci dhe veçanërisht me golin e shënuar në minutën e 96-të, që i dha skuadrës së tij fitoren 2-1 ndaj Dundee-t më 6 shtator.

Risi priten edhe nga Dinamo City, me Klevis Qefalian, Usni Ismailin dhe Naser Alijin në listën e pritjes dhe të vëzhgimit.

Qefalia dhe Ismaili janë emra të rinj për Kombëtaren A, ndërsa Aliji ka pasur më parë eksperiencë me fanellën kuqezi dhe mund të rikthehet në konsideratë.

Mungesa dhe rikthime

të fundit /



Tifozi i Partizanit krahason ekipin me gruan: "Edhe kur...



Gjykimi ndaj katër ish-kreerëve të UÇK-së, Çitaku: Rama veptoi ...



Zhvillohet seanca për 53 të pandehurit në mungesë për masakr...



Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes...



Zendaya, Selena Gomez dhe emrat më të ndritur të kinemasë...



Aston Villa shqyrton afrimin e Sergio Ramosit



Erion Veliaj kërkon lirin nga burgu, Gjykata e Lartë...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Sa i përket situatës së lojtarëve, mungesa e konfirmuar është ajo e Thomas Strakoshës. Portieri kuqezi ka pësuar një frakturë në kyçin e dorës dhe pritet të qëndrojë jashtë për të paktën katër javë, duke humbur kështu të katërta ndeshjet e këtij cikli. Në anën tjetër, Ernest Muçi është rikthyer në aktivitet dhe po vjen në një moment të mirë, ndërsa Rey Manaj dhe Taulant Seferi janë gjithashtu kandidatë për rikthim në grup. Nazmi Gripshi mbetet në dispozicion dhe nuk ka arsye të klasifikohet si mungesë për shkak dëmtimi.

Seanca e parë stërvitore e Kombëtares do të zhvillohet të hënën, më 21 shtator, ndërsa Shqipërinë e presin katër ndeshje në një hark shumë të shkurtër kohor.

26 shtator, ora 20:45 – Shqipëri-Bjellorusi

29 shtator, ora 20:45 – San Marino-Shqipëri

3 tetor, ora 15:00 – Finlandë-Shqipëri

6 tetor, ora 20:45 – Shqipëri-San Marino

Me rreth 50 ftesa të shpërndara paraprakisht, trajneri italian po kërkon të ketë një panoramë të plotë përpara vendimit final. Në listën e tij janë emrat e konsoliduar, rikthimet, por edhe futbollistë që mund të marrin për herë të parë një mundësi me Kombëtaren A. Lista zyrtare e 18 shtatorit do të zbulojë se cilët prej tyre do të jenë pjesë e grupit, por sinjalet janë të qarta: Maran po zgjeron ndjeshëm rrethin e lojtarëve të vëzhguar.

Shtuar më 15.09.2026 08:32

Tags: 50 ftesa , kombetarja , Maran



Erion Veliaj kërkon lirimin nga burgu, Gjykata e Lartë shqyrton sot masën e...



Selin Bollati zbulon çfarë ka ndodhur me 100 mijë eurot



Euro prek 91.8 lekë, rekord i ri historik/ Zhvlerësimi arrin në 5.1% që nga filli...



Protestuesit marshojnë drejt Gjykatës së Lartë, një ditë para vendimit për Veliaj



Skandali "Kayo", Hoxhaj: Shteti dha 30 milionë euro për mjete të salduara në...



Audiopërgjimet e Ron Yeffet, Artan Hoxha: Balluku drejtoi personalis...



"Kush e drejton realisht shtetin?"/ Bardhi reagon pas audiopërgjimeve të...



Koçu për alarmin e rremë në shkollë: Çmenduri kriminale, ligji të...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.